



Polytechnic University of Tirana
Institute of Geosciences
Department of Meteorology



2023

VOLUMI / VOLUME NR.7
NUMRI / ISSUE 81

SHTATOR/ SEPTEMBER

**BULETINI MUJOR
KLIMATIK
CLIMATE MONTHLY
BULLETIN**

www.geo.edu.al

ISSN: 2521-831X

Scientific & Editorial Board

Prof.Dr. Petrit ZORBA – Chief Editor & Member of the Department of Meteorology, PUT – IGEO, Tirana, Albania.

Akad. Floran VILA - Academy of Sciences, Tirana, Albania.

Prof. Kimmo KASKI, President of the Finnish Academy of Science and Letters.

Prof.Dr. Gjergj IKONOMI – “POLIS” University - Tirana, Albania.

Ph.D. Çezar KONGOLI – Earth System Science Interdisciplinary Center (ESSIC), University of Maryland College Park & Visiting Scientist, National Oceanic and Atmospheric Administration (NOAA), Maryland, USA.

Dr. Azem BARDHI – Head of the Department of Meteorology, PUT – IGEO, Tirana, Albania.

External Reviewers:

Ph.D. Sante LAVIOLA, - National Research Council of Italy (CNR), Institute of Atmospheric Sciences and Climate (ISAC), Bologna, Italy.

English Supervisor: Eng. Elsuida HOXHA, PhD Student, Grove School of Engineering, CCNY, NY, USA

The Editorial Advisory Board approved by the Director of IGEO –

Prof.Dr. Ylber MUCEKU

Ky buletin u realizua me kontributin e punonjësve të Departamentit të Meteorologjisë së IGJEO sipas rubrikave si vijon:

This bulletin has been realized by the staff contribution of the Department of Meteorology of IGEO by rubrics as follows:

Data digitalization: M.Sc. Gentiana STAFA

Data control, verification & and elaboration:

Prof.Dr. Petrit ZORBA, M.Sc. Gazmir ÇELA, Eng. M.Sc. Elsuida HOXHA,
Eng. M.Sc. Anira GJONI.

Synoptic situation: Prof.Dr. Petrit ZORBA, M.Sc. Gentiana STAFA

Evaluation of monthly meteorological characteristics:

Prof.Dr. Petrit ZORBA, M.Sc. Gazmir ÇELA

Solar radiation: Prof.Dr. Petrit ZORBA & M.Sc. Gazmir ÇELA

Air temperatures: Prof.Dr. Petrit ZORBA

Atmospheric precipitation: Prof.Dr. Petrit ZORBA, M.Sc. Gazmir ÇELA

Agrometeorology: Prof.Dr. Petrit ZORBA

Fires - Summer 2023: M.Sc. Gazmir ÇELA

Climate Change: Prof.Dr. Petrit. ZORBA

Experimental Scientific Work: Prof.Dr. Petrit ZORBA

The cover of this bulletin is composed and prepared by

Eng. M.Sc. Elsuida HOXHA

PËRMBAJTJA / CONTENTS

| | |
|----|---|
| 04 | HYRJA INTRODUCTION |
| 05 | SITUATA SINOPTIKE SYNOPTIC SITUATION |
| 07 | RREZATIMI DIELLOR SOLAR RADIATION |
| 11 | TEMPERATURAT E AJRIT AIR TEMPERATURES |
| 18 | RESHJET ATMOSFERIKE ATMOSPHERIC PRECIPITATION |
| 26 | AGROMETEOROLOGJI AGROMETEOLOGY |
| 24 | ZJARRET - VERA 2023 FIRES - SUMMER 2023 |
| 30 | NDRYSHIMET KLIMATIKE CLIMATE CHANGE |
| 32 | ARTIKULL SHKENCOR SCIENTIFIC PAPER |

Buletini Mujaor Klimatik Nr. 81 - 2023 ndodhet i publikuar në faqen "on line" të OBM, UPT, IGEO dhe një sërë institucioneve të tjera. Për buletinet e tjera mund të klikoni në logot përkatëse, që ndodhen në vijim.

Monthly Climate Bulletin Nr. 81 - 2023 is published on the web site of WMO, PUT, IGEO and other institutions. For the other bulletins you can click on the respective logo, that are listed below.




HYRJE

Muaji shtator 2023 pati si karakteristika kryesore meteorologjike dy elemente, të cilët shënuan dhe anomali të theksuara nga pikëpamja klimatike për këtë muaj.

Së pari pjesa qendrore e kontinentit European u karakterizua me një nivel të lartë të rrezatimit diellor duke evidentuar një anomali pozitive, e cila shënoi vlera deri në +40% kudrejt atyre të normës së rrezatimit diellor për këtë muaj; ndërkohë që disa vende mesdhetare si Spanja e Greqia shënuan së bashku me një pjesë të vendeve të Afrikës veriore anomali negative dhe mjaft me pak orë me diell se vlerat e normës. Sigurisht kjo situatë u reflektua dhe ndikoi respektivisht dhe në performancën e sistemeve fotovoltaike dhe rendimentin e tyre në këto vende.

Krahas kësaj dukurie është dhe situata e veçantë e krijuar me stuhi dhe përmytje që erdhi si pasojë e zhvillimeve të qendrës ciklonare me presion të ulët atmosferik që përcolli mjaft deme në Greqi, Turqi, si dhe ato me pasoja më katastrofike dhe ekstreme që u vrojtuan në vendet e Afrikës veriore, ku mund të përmendet situata në Libi, ku u dëmtuan dy diga dhe u shënuan mjaft humbje jetësh njerëzore.

Në figurën Nr.1 paraqitet harta me reshjet çdo 3 orë për datën 5 shtator 2023 ora 11⁰⁰, ku dukshëm dallohet që vendi ynë është kësaj situatë.



INTRODUCTION

The month of September 2023 had as its main meteorological characteristics two elements, which also marked significant anomalies from the climate point of view for this month.

First, the central part of the European continent was characterized by a high level of solar radiation, evidencing a positive anomaly, which marked values up to +40% compared to those of the solar radiation norm for this month; while some Mediterranean countries such as Spain and Greece, together with a part of the North African countries, recorded negative anomalies and quite a few hours of sunshine than the normal values. Of course, this situation was reflected and affected respectively the performance of photovoltaic systems and their yield in these countries.

In addition to this phenomenon, there is also the special situation created with storms and floods that came as a result of the development of the cyclonic center with low atmospheric pressure that caused a lot of damage in Greece, Turkey, as well as those with more catastrophic and extreme consequences that were observed in the countries of northern Africa, where the situation in Libya can be mentioned,

where two dams were damaged and many human lives were lost.

Figure No. 1 shows the map with precipitation every 3 hours for September 5, 2023 at 11⁰⁰, where it is evident that our country is outside of this situation.

SITUATA SINOPTIKE

Gjatë muajit shtator 2023 u vu re pozicionim i ndryshëm i subjekteve sinoptike në kontinentin Europian. Në ditët e para ka patur dy qendra të thella ciklonare në gjërësitë 60 gradë veriore. Dy qendra të tjera të ulta identike me 1004 mb u vendosën njëra në oqeanin Atlantik dhe tjetra në brigjet juglindore të Mesdheut. Këto i lanë vend depërtimit të masave të nxehta Afrikane në brigjet e Spanjës e deri në brigjet jugore të Skandinavisë. Kjo lloj vendosje quhet "omega". Nga vetë forma e saj me ndryshimet e forta brenda bregut të Mesdheut, arrin të nxisë ciklone të fortë, ashtu siç u përjetua në shtetin fqinj. Cikloni apo stuhia "Daniel", në figurën Nr.2, ishte tipike e fundit të verës ku ajri i ftohtë i menjëhershëm, takon në masë ujore me temperaturë të lartë e që më pas sjell reshje intensive dhe stuhi të njëpasnjëshme.

Gjatë dekadës të dytë të muajit shtator depërtoi fusha barike e presionit të lartë atmosferik prej brigjeve perëndimore të Mesdheut deri në rrethin arktik. Në pjesën më të madhe të kontinentit mbizotëroi moti i qendrueshëm me temperaturat tipike të vjeshtës gjatë mbrëmjes e mëngjesit.

SINOPTIC SITUATION

During the month of September 2023, different positioning of synoptic subjects was observed on the European continent. In the first days, there were two deep cyclonic centers in the latitudes of 60 degrees north. Two other identical low centers at 1004 mb were located, one in the Atlantic Ocean and the other on the southeastern shores of the Mediterranean. These gave way to the penetration of hot African masses on the coast of Spain and up to the southern coast of Scandinavia. This type of placement is called "omega". From its very shape with the strong changes within the Mediterranean coast, it manages to induce strong cyclones, as was experienced in the neighboring country. Cyclone or storm "Daniel", in picture No.2, was typical of the end of the summer where the cold air immediately meets the water bodies with high temperature, which then brings intense rain and successive storms.

During the second decade of September, the baric field of high atmospheric pressure penetrated from the western shores of the Mediterranean to the Arctic Circle. In most parts of the continent, stable weather prevailed with typical autumn temperatures during the evening and the morning.




Figure Nr.2 – Stuhia / Storm
"Daniel" NOAA




Figure Nr.3 – Frontet atmosferike /
Atmospheric fronts 13/09/2023
Ventusky



Figure Nr.4 – Koma /COMMA
20/09/2023 - CMMCA



Figure Nr.5 – Stuhia /Storm
"Elias" 27/09/2023 - CMMCA

Në pjesën tjetër të Europës perëndimore frontet e lidhur në seri me njëri-tjetrin prej brigjeve të Atlantikut deri në veri të Skandinavisë sollën reshje dhe rënie temperaturash. Kjo situatë pasqyrohet në figurën Nr.3.

Dekada e tretë në rajon nisi me pozicionimin e një Comma mesdhetare që paraqitet në figurën Nr.4. Pozicionimi i saj në brigjet e deteve Ligur dhe Tiren në pjesën perëndimore dhe veriperëndimore të Italisë, shtrëngata, stuhi dhe breshër. Përmbetje pati në Milano në mesditën e datës 20 shtator 2023.

Fundi i muajit erdhi me tiparet e një vjeshte të vërtetë në gadishullin e Ballkanit dhe në territorin shqiptar. Një ciklon mesdhetar Elias me qendër në detin Jon bëri të mundur ardhjen e një mase ajrore më të freskët shoqëruar me erëra verilindore e cila arriti maksimumin e vet në brigjet detare.

Reshjet e shiut ishin të karakterit të rrebesheve me rrufe dhe breshër me aktivitet më të madh në jug e qendër të Greqisë me përmbetje dhe erëra të forta figura Nr.5.


Fazat përfundimtare të kësaj stuhie shoqëruar dhe me reshje intensive, përmbetje dhe dëme të shumta u evidentuan në territorin e Libisë, që me pamjen e dhënë në vijim në figurën Nr. 6 ilustron situata e reshjeve 3 orëshe të datës 10 shtator 2023 ora 11⁰⁰.

In the rest of western Europe, fronts connected in series with each other from the Atlantic coast to the north of Scandinavia brought precipitation and a drop in temperature. This situation is reflected in figure No.3.

The third decade in the region started with the positioning of a Mediterranean Comma that is presented in figure No.4. Its positioning on the shores of the Ligurian and Tyrrhenian seas in the western and northwestern part of Italy, convulsions, storms and hail. There was a flood in Milan at noon on September 20, 2023. The end of the month came with the features of a real autumn in the Balkan peninsula and in the Albanian territory. A Mediterranean cyclone Elias centered in the Ionian Sea made possible the arrival of a cooler air mass accompanied by northeasterly winds which reached its maximum on the sea coasts.

The rainfall was characterized by lightning and hailstorms with greater activity in the south and center of Greece with flooding and strong winds figure No.5.

The final stages of this storm, accompanied by intense rain, numerous floods and damages, were evident in the territory of Libya, which are shown below in figure No.6 by the rainfall situation for 3 hours on September 10, 2023 at 11⁰⁰.



RREZATIMI DIELLOR

Rrezatimi diellor gjatë muajit shtator 2023 në kontinentin European shënoi vlera të larta dhe anomali mjaft të theksuara pozitive, sidomos në pjesën qendrore dhe verilindore.

Në hartat e dhëna në vijim në figurat Nr.7 dhe Nr.8 paraqiten të dhënat e kohëzgjatjes së diellzimit në orë për muajin shtator 2023 si dhe të anomalive të standartizuara kundrejt periudhës mesatare shumëvjeçare 1991-2020.

SOLAR RADIATION

The solar radiation during the month of September 2023 in the European continent marked high values and quite pronounced positive anomalies, especially in the central and northeastern part.

In the following maps, in figures No.7 and No.8, the data of the duration of sunshine in hours for the month of September 2023 as well as the standardized anomalies compare to the multi-year average period 1991-2020 are presented.

Kohëzgjatja e diellzimit – shtator 2023 Sunshine duration – September 2023




Figure Nr.7

Orë / Hours


Sa i takon anomalive negative ato u shënuan në gadishullin Iberik si dhe në pjesën JL të gadishullit të Ballkanit si dhe në pjesën juglindore të Mesdheut.

Në veçanti për territorin e Shqipërisë vlerat e këtij treguesi paraqiten në hartën e dhënë në figurën Nr.9, ku qartë dallohen për vlera të larta kryesisht pjesa e Ultesirës Perëndimore. Disa të dhëna mbi kohëzgjatjen ditore të diellzimit në orë referuar disa vendmatjeve të përzgjedhura si Rapsh, Fier dhe Belsh janë paraqitur në grafikët e dhënë në figurën Nr.10/1-3.

As for the negative anomalies, they were noted in the Iberian peninsula as well as in the SE part of the Balkan peninsula as well as in the SE part of the Mediterranean.

In particular, for the territory of Albania, the values of this indicator are presented in the map given in figure No.9, where the high values, mainly the part of the Western Lowlands, are clearly distinguished. Some data on the daily sunshine duration in hours with reference to some selected stations such as Rapsh, Fier and Belsh are presented in the graphs given in figure No.10/1-3.


Anomalia e standartizuar e kohëzgjatjes së diellzimit – shtator 2023
 Standardized anomaly of sunshine duration – September 2023
 (periudha e referencës / reference period 1991-2020)



Bazuar në instrumentin matës të diellzimit siç është pajisja e heliografit model Campbell Stokes, treguar në figurën Nr.10/4 në disa prej vendmatjeve meteorologjike kryhen matje mbi kohëzgjatjen e treguesit të diellzimit apo orëve me diell që vrojtohen çdo ditë në Shqipëri.

Based on the insolation measuring instrument such as the Campbell Stokes model heliograph device, shown in figure No.10/4, measurements are made on the duration of the insolation indicator or sunny hours that are observed every day in some of the meteorological station in Albania.

Kohëzgjatja e diellzimit – Shqipëria, Shtator 2023
 Sunshine duration – Albania, September 2023



Diellëzimi për muajin shtator 2023 - vendmatja meteorologjike Rapsh, Albania
Sunshine for September 2023 - Meteorological station Rapsh, Albania




Figure Nr.10/1

Diellëzimi për muajin shtator 2023 - vendmatja meteorologjike Fier, Albania
Sunshine for September 2023 - Meteorological station Fier, Albania




Figure Nr.10/2

Diellëzimi për muajin shtator 2023 - vendmatja meteorologjike Belsh, Albania
Sunshine for September 2023 - Meteorological station Belsh, Albania




Figure Nr.10/3



Figure Nr.10/4

Pajisje e heliografit në vendmatjet meteorologjike të Shqipërisë.

Heliograph on the meteorological station of Albania.
(Campbell Stokes sunshine duration recorder)

Vlera Mesatare Ditore e Rrezatimit Global Horizontal për Europën
për muajin shtator 2023
Average Daily Global Horizontal Irradiance for Europe for
September 2023




Figure Nr.11



Vlera Ditore të Rrezatimit Global Horizontal (në kWh)
Daily Global Horizontal Irradiance (in kWh)

Të gjitha sistemet fotovoltaike në Gjermani dhe vendet pranë këtë muaj shtator 2023 shënuan rekorde pozitive në performancën e tyre të punës, duke prodhuar deri në 40% me shume energji elektrike, falë një rrezatimi diellor dhe numri orësh me diell më të lartë se norma.

Përkundër kësaj vendet e pjesës JL të kontinentit tonë shënuan një rënie prej deri 20 % si pasojë e një niveli më të lartë të vranësirave dhe një ulje të kohëzgjatjes së periudhave me diellzim.

All photovoltaic systems in Germany and neighboring countries set positive records in their work performance this month, September 2023, producing up to 40% more electricity, thanks to solar radiation and the number of sunny hours above the norm.

Contrary to this country in the SE part of our continent, they recorded a decrease of up to 20% as a result of a higher level of cloudiness and a decrease in the duration of sunny periods.

TEMPERATURAT E AJRIT

Muaji shtator 2023 rezultoi muaji më i ngrohtë në shkallë globale, me një vlerë prej 16.38°C ose +0.93°C më të lartë se mesatarja e periudhës 1991-2020 si dhe me një anomali prej +0.5°C mbi temperaturën e muajit shtator më të ngrohtë të mëparshëm, atij të vitit 2020.

Një paraqitje e situatës së temperaturave të ajrit dhe anomalive të tyre për muajin shtator 2023 në shkallë globale dhe për kontinentin Europian jepet në hartat e dhëna në figurën Nr.12 dhe Nr.13, ku dukshëm dallon që Europa gjatë këtij muaji shënoi anomali të larta pozitive.

AIR TEMPERATURES

September 2023 turned out to be the warmest month on a global scale, with a value of 16.38°C or +0.93°C higher than the average of the period 1991-2020, as well as with an anomaly of +0.5°C above the temperature of the month of September with warm before, that of 2020.

A presentation of the situation of air temperatures and their anomalies for September 2023 on a global scale and for the European continent is given in the maps given in the figure No.12 and No.13, where it is evident that Europe during this month marked high anomalies positive.




Figure Nr.12 - Anomalitë e temperaturës së ajrit pranë sipërfaqes për muajin shtator 2023 kundrejt periudhës 1991÷2020 në shkallë globale dhe për kontinentin Europian. Surface air temperature anomaly in global scale and for the European continent for September 2023 compared to the period 1991÷2020 (Copernicus, ECMWF, etc.).




Figure Nr.13 - Vlerat e temperaturave mesatare të ajrit dhe anomalive të tyre për kontinentin Europian për muajin shtator 2023, sipas NOAA-s. Values of mean air temperatures and their anomalies for the European continent for the month of September 2023, according to NOAA.

Temperatura mesatare e ajrit gjatë 9 muajve të parë të vitit 2023 në shkallë globale pati vlerën $+0.52^{\circ}\text{C}$ më të lartë se ajo mesatare e periudhës 1991-2020, si dhe një anomali prej $+0.05^{\circ}\text{C}$ më të lartë se ajo e periudhës më të ngrohtë të mëparshme që i takonte vitit 2016. Nga pikëpamja historike temperatura mesatare globale për periudhën janar-shtator 2023 ishte rreth $+1.40^{\circ}\text{C}$ më e lartë se ajo e periudhës para industriale 1850-1900. Shih dhe figurën Nr.14.


Në lidhje me kontinentin Europian muaji shtator 2023 u karakterizua me vlera rekord, duke shënuar një anomali prej $+2.51^{\circ}\text{C}$ më të lartë se ajo e periudhës 1991-2020 dhe $+1.1^{\circ}\text{C}$ më të lartë se e ajo e muajit më të ngrohtë të mëparshëm shtator 2020. Ndërkohë evidentohet dhe fakti që temperatura mesatare sipërfaqesore e ujit për gjerësitë gjeografike $60^{\circ}\text{J} - 60^{\circ}\text{V}$ për këtë muaj u arrit në vlerën 20.92°C duke përbërë vlerën më të lartë në vrojtimet ndër vite si dhe duke shënuar vlerën e dytë pas gushtit 2023 si më të lartë.

The average air temperature during the first 9 months of 2023 on a global scale had a value of $+0.52^{\circ}\text{C}$ higher than the average of the period 1991-2020, as well as an anomaly of $+0.05^{\circ}\text{C}$ higher than that of the warmer period than the previous one that belonged to the year 2016. From a historical point of view, the average global temperature for the period January September 2023 was about $+1.40^{\circ}\text{C}$ higher than that of the pre-industrial period 1850-1900. See also the figure Nr.14. Regarding the European continent, the month of September 2023 was characterized by record values, marking a $+2.51^{\circ}\text{C}$ anomaly, higher than that of the period 1991-2020 and $+1.1^{\circ}\text{C}$ higher than that of the warmest month of September 2020. Meanwhile, the fact that the average surface temperature of water for latitudes $60^{\circ}\text{S} - 60^{\circ}\text{W}$ for this month reaches the value of 20.92°C , constituting the highest value in the observations over the years, as well as marking the second value after August 2023 as the highest.

Paraqitje grafike e ecurisë së anomaliave të temperaturave globale të ajrit të sipërfaqes për muajin shtator.

Graphic presentation of global surface air temperature anomalies for September.

Figure Nr.14.



Në mënyrë më të detajuar anomalitë e temperaturave të ajrit për 4 javët e muajit shtator 2023 në shkallë kontinentale paraqiten në hartat e dhëna në figurën Nr.15, ku Shqipëria përfshihet në hapësirat me anomali pozitive.

Gjithashtu në vijim për një sërë vendmatjesh meteorologjike të përzgjedhura për zona e nënzona të ndryshme klimatike të

In more detail, air temperature anomalies for the 4 weeks of September 2023 on a continental scale are presented in the maps given in figure No.15, where Albania is included in the areas with positive anomalies.

Also, in the following for a series of meteorological measurement sites selected for different climatic zones and subzones






Figura Nr.15. -Vlerat e anomalive të temperaturave mesatare të ajrit për kontinentin Europian për 4 javët e muajit shtator 2023, sipas NOAA-s. / Anomaly values of average air temperatures for the European Continent for the 4 weeks of September 2023, according to NOAA.

Shqipërisë paraqiten grafikisht të dhënat e ecurisë ditore të temperaturave të ajrit për 12 vendmatje në figurën Nr.16/1-16/12. Sa i takon vlerave të temperaturave mesatare të ajrit, siç paraqitet dhe në grafikun e figurës Nr.17 të dhënat ecurisore të temperaturave të ajrit të tregojnë një anomali pozitive prej +2.9°C për muajin shtator 2023 për Shqipërinë. Natyrisht ashtu si dhe në muajt e mëparshëm vijojnë të ruhen dhe në muajin shtator 2023 anomali më të larta, pikërisht nga temperaturat maksimale të ajrit. Ato në shkallë kontinentale për 4 javët e këtij muaji janë paraqitur në hartat e figurës Nr.18, ndërsa për vendin tonë paraqiten grafikisht në figurën Nr.19 ku ecurisore të temperaturave të ajrit të tregojnë një anomali prej +3.5°C.


of Albania, the daily air temperature data for 12 stations are presented in figure No.16/1-16/12. Regarding the values of the average air temperatures, as shown in the graph of figure No.17, the data present a positive anomaly of +2.9°C for the month of September 2023 for Albania. Of course, as in the previous months, higher anomalies continue to be observed in the month of September 2023, precisely from the maximum air temperatures. Those on a continental scale for the 4 weeks of this month are presented in the maps of figure No.18, while for our country they are presented graphically in figure No.19 where an anomaly of +3.5°C is evident.

Figure Nr.16/1÷16/12 - Temperaturat dhe reshjet ditore për disa vendmatje meteorologjike për muajin shtator 2023 në Shqipëri.
The daily temperatures and precipitation for some meteorological stations for September 2023 in Albania.





*Figure Nr.17. - Vlerat e temperaturave mesatare të ajrit për disa vendmatjet meteorologjike të muajit shtator 2023 si dhe ato të normës për Shqipërinë.
 Values of mean air temperatures for some meteorological stations of September 2023*



*Figura Nr.18. - Vlerat e temperaturave maksimale ekstreme të ajrit për kontinentin European për 4 javët e muajit shtator 2023, sipas NOAA-s.
 Extreme maximal values of air temperatures for European Continent for the 4 weeks of September 2023, according to NOAA.*




Figure Nr.19. - Vlerat e temperaturave mesatare maksimale të ajrit për disa vendmatjet meteorologjike të muajit shtator 2023 për Shqipërinë.

Values of mean maximal air temperatures for some meteorological stations of September month 2023 for Albania.

Muaji shtator si një tejzgjatje e stinës së verës në vitet e fundit edhe këtë vit nuk bëri përjashtim. Temperaturat e larta vijuan të ishin të pranishme. Në vijim në figurën Nr.20 paraqiten grafikisht vlerat e temperaturave maksimale absolute të disa prej vendmatjeve meteorologjike të muajit shtator 2023 në territorin e vendit tonë.

The autumn month as an extension of the summer season in recent years and this year was no exception. High temperatures continued to be present. In the following figure No.20, the values of the maximum absolute temperatures of some of the meteorological stations for September 2023 in the territory of our country are graphically presented.




Figure Nr.20 - Vlerat e temperaturave maksimale absolute të ajrit për disa vendmatjet meteorologjike të muajit shtator 2023 për Shqipërinë.

Values of maximal absolute air temperatures for some meteorological stations of September 2023 for Albania.

Gjatë këtij muaji edhe vlerat e temperaturave minimale të ajrit u karakterizuan me anomali pozitive. Në hartat e dhëna për 4 javët e këtij muaji ato paraqiten në shkallë kontinenti në figurën Nr.21, ndërsa grafikisht për disa vendmatje meteorologjike të Shqipërisë janë dhënë në figurën Nr.22 ku evintohet një anomali prej +2.3°C. Temperaturat minimale absolute nuk zbritën nën pragun 5°C në pjesën më të madhe të vendmatjeve meteorologjike.

During this month, the minimum air temperature values were also characterized by positive anomalies. In the maps given for the 4 weeks of this month, they are presented on a continental scale in figure No.21, while the graphs for some meteorological stations in Albania are given in figure No.22, where an anomaly of +2.3°C is observed. The absolute minimum temperatures do not drop below the threshold of 5°C in most of the meteorological stations.




Figura Nr.21. - Vlerat e temperaturave minimale ekstreme të ajrit për kontinentin Europian për 4 javët e muajit shtator 2023, sipas NOAA-s.
 Extreme minimal values of air temperatures for European Continent for the 4 weeks of September 2023, according to NOAA.





Figure Nr.22 - Vlerat e temperaturave mesatare minimale të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit shtator 2023 për Shqipërinë.
 Values of minimum mean air temperatures for some meteorological stations of September 2023 for Albania.

RESHJET ATMOSFERIKE

Gjatë muajit shtator 2023 në pjesën më të madhe të kontinentit European u shënuan vlera nën normë të reshjeve. Anomalitë pozitive ishin kryesisht në gadishullin Iberik dhe në Britani, ndërkohë që në pjesën qendrore të kontinentit dhe në gadishullin Ballkanik u regjistruan anomali të theksuara negative të reshjeve atmosferike. Vlerat e reshjeve (në mm) dhe anomalive të tyre kundrejt normës të shprehura në % në shkallë kontinentale për muajin shtator 2023 paraqiten në hartat e dhëna në figurën Nr.23.

ATMOSPHERIC PRECIPITATION

During the month of September 2023, in most parts of the European continent, values below the rainfall norm were recorded. Positive anomalies were mainly in the Iberian Peninsula and in Britain, while in the central part of the continent and in the Balkan Peninsula significant negative anomalies of atmospheric precipitation were recorded. Rainfall values (in mm) and their anomalies compare to the norm expressed in % on a continental scale for the month of September 2023 are presented in the maps given in figure No.23.



*Figura Nr.23 - Reshjet për muajin shtator 2023 në kontinentin European dhe anomalitë kundrejt periudhës 1981 ÷ 2010, sipas NOAA-s.
Rainfall for September 2023 at the European continent and their anomalies referring to the period 1981 ÷ 2010 according to NOAA.*

Të dhënat e reshjeve për një sërë vendmatjesh meteorologjike të përzgjedhura, që i përkasin zonave dhe nënzonave të ndryshme klimatike të vendit tonë për muajin shtator 2023 janë paraqitur në tabelën Nr.1.

Në tërësinë e tyre të dhenat e reshjeve për këtë muaj tregojnë në shkallë vendi një anomali negative me rreth -40.7% kundrejt vlerave të mesatares shumëvjeçare referuar periudhës 1961-1990, ndërsa ditët me reshje një anomali prej -31%.

Më të theksuara këto anomali siç shihet dhe në hartën Europiane janë në pjesën JP të Shqipërisë.

Rainfall data for a series of selected meteorological measurement sites, belonging to different climatic zones and subzones of our country for the month of September 2023, are presented in table No.1.

In their entirety, the rainfall data for this month show a negative anomaly of about -40.7% compared to the values of the multi-year average referring to the period 1961-1990, meanwhile the rainy days shows an anomaly of -31%.


The most prominent of these anomalies, as can be seen on the European map, are in the SW part of Albania.

*Tabela / Table Nr.1 – Reshjet për muajin shtator 2023 (në mm) si dhe treguesit e numrit të ditëve me reshje mbi pragun 0.1mm dhe reshjet maksimale 24 orëshe (në mm).
Precipitation for September 2023 (in mm) as well as indicators of the number of rainy days above the 0.1 mm threshold and the maximum 24-hour precipitation (in mm).*

| Nr. | Vendmatja meteorologjike Meteorological station | Reshjet Precipitation (në / in mm) | Ditë me reshje Rainy days number (>0.1 mm) | Reshjet maksimale 24 orëshe Maximal 24-hour precipitation (në / in mm) | Nr. | Vendmatja meteorologjike Meteorological station | Reshjet Precipitation (në / in mm) | Ditë me reshje Rainy days number (>0.1 mm) | Reshjet maksimale 24 orëshe Maximal 24-hour precipitation (në / in mm) |
|-----|--|--|---|--|-----|--|--|---|--|
| 1 | Ballsh | 14.5 | 4 | 5.0 | 44 | Kurbnesh | 60.0 | 6 | 15.0 |
| 2 | Belsh | 41.0 | 1 | 41.0 | 45 | Lekbibaj | 26.5 | 2 | 24.1 |
| 3 | Bilisht | 40.9 | 5 | 16.8 | 46 | Lezhë | 51.7 | 3 | 42.3 |
| 4 | Bishnicë | 21.5 | 3 | 18.0 | 47 | Librazhd | 11.0 | 1 | 11.0 |
| 5 | Bogë | 37.0 | 4 | 14.6 | 48 | Likmetaj | 57.0 | 3 | 31.0 |
| 6 | Brataj | 18.0 | 2 | 14.0 | 49 | Liqenas | 39.9 | 6 | 17.4 |
| 7 | Bushat | 54.5 | 5 | 35.5 | 50 | Macukull | 61.0 | 5 | 42.0 |
| 8 | Çorovodë | 9.5 | 2 | 5.5 | 51 | Mashterkor | 84.0 | 6 | 29.0 |
| 9 | Çukë | 30.9 | 4 | 14.8 | 52 | Nivicë | 25.0 | 3 | 10.0 |
| 10 | Dajç-Bunë | 84.5 | 4 | 70.0 | 53 | Orikum | 13.3 | 5 | 5.0 |
| 11 | Dajt Rez. | 24.8 | 4 | 22.5 | 54 | Peqin | 15.5 | 4 | 11.3 |
| 12 | Dardhë | 40.2 | 5 | 14.7 | 55 | Përmet | 21.1 | 4 | 13.5 |
| 13 | Domgjon | 30.0 | 4 | 12.5 | 56 | Petkaj | 13.5 | 2 | 8.4 |
| 14 | Dragobi | 70.5 | 4 | 50.0 | 57 | Petrelë | 34.0 | 2 | 30.0 |
| 15 | Durrës | 27.4 | 3 | 17.0 | 58 | Petresh | 38.2 | 2 | 24.2 |
| 16 | Dushar | 44.0 | 5 | 35.0 | 59 | Pogradec | 79.1 | 6 | 43.8 |
| 17 | Dushman | 43.0 | 6 | 15.0 | 60 | Poliçan | 118.5 | 4 | 71.0 |
| 18 | Elbasan | 48.0 | 2 | 24.0 | 61 | Potom | 69.0 | 4 | 33.0 |
| 19 | Ersekë | 96.4 | 8 | 59.4 | 62 | Prenjas | 72.1 | 5 | 48.0 |
| 20 | Fier | 2.5 | 1 | 2.5 | 63 | Pukë | 55.0 | 7 | 21.0 |
| 21 | Fratar | 23.0 | 3 | 20.0 | 64 | Qafzez | 15.0 | 4 | 6.0 |
| 22 | Fshat Klos | 52.6 | 5 | 34.6 | 65 | Qarrishtë | 70.0 | 4 | 40.0 |
| 23 | Gojan | 47.1 | 4 | 21.0 | 66 | Rapsh | 42.4 | 4 | 16.8 |
| 24 | Goric e madhe | 57.8 | 7 | 19.0 | 67 | Rrëshen | 63.0 | 4 | 37.0 |
| 25 | Grabovë | 37.0 | 3 | 28.0 | 68 | Shengjergj | 55.0 | 2 | 40.0 |
| 26 | Himarë | 7.0 | 3 | 3.0 | 69 | Shënkoll | 54.0 | 2 | 44.0 |
| 27 | Hoshtevë | 80.7 | 3 | 63.3 | 70 | Sheqeras | 40.0 | 1 | 40.0 |
| 28 | Hot | 38.0 | 5 | 13.0 | 71 | Shishtavec | 213.0 | 5 | 135.0 |
| 29 | Jaronisht | 81.0 | 4 | 48.0 | 72 | Shtyllë | 65.0 | 4 | 30.0 |
| 30 | Kalimash | 30.8 | 4 | 24.0 | 73 | Shupenzë | 53.0 | 2 | 44.0 |
| 31 | Kallmet | 56.4 | 5 | 38.5 | 74 | Sinjë | 26.2 | 3 | 25.6 |
| 32 | Kallmet L. | 71.0 | 4 | 34.0 | 75 | Stravaj | 49.3 | 2 | 45.3 |
| 33 | Kardhiq | 31.0 | 7 | 9.0 | 76 | Sukth | 24.5 | 3 | 22.0 |
| 34 | Kilojkë | 38.0 | 4 | 20.0 | 77 | Tepelenë | 26.9 | 3 | 15.5 |
| 35 | Konispol | 20.0 | 4 | 6.0 | 78 | Tërpan | 25.5 | 5 | 17.0 |
| 36 | Koplik | 57.4 | 5 | 40.8 | 79 | Tiranë | 39.0 | 4 | 33.0 |
| 37 | Korçë | 37.4 | 7 | 7.6 | 80 | Topojan | 13.5 | 3 | 9.9 |
| 38 | Korthpulë | 68.0 | 2 | 38.0 | 81 | Tropojë | 32.3 | 5 | 15.3 |
| 39 | Krahës | 18.4 | 9 | 9.0 | 82 | Ura e Shtrenjtë | 14.0 | 2 | 9.0 |
| 40 | Krujë | 18.0 | 6 | 7.1 | 83 | Voskopojë | 59.6 | 4 | 52.2 |
| 41 | Kryevidh | 15.0 | 3 | 8.0 | 84 | Vrith | 34.0 | 3 | 20.0 |
| 42 | Kuç | 18.0 | 6 | 7.1 | 85 | Zerqan | 164.0 | 3 | 135.0 |
| 43 | Kukës | 10.2 | 1 | 10.2 | 86 | Zogaj | 30.0 | 1 | 30.0 |


Nga të dhënat rezulton se në vendmatjen e Zerqanit në VL të Shqipërisë u shënuar dhe vlera më lartë e reshjeve maksimale 24 orëshe prej 135.0 mm. Vlerat më të ulta të lartësive të reshjeve mujore u shënuan në Fier 2.5 mm dhe në Himarë 7.0 mm.

From the data, it appears that the highest value of the maximum 24-hour rainfall of 135.0 mm was recorded in the Zerqan station in the NE of Albania. The lowest values of monthly rainfall were recorded in Fier 2.5 mm and in Himare 7.0 mm.



Një pasqyrë e shpërndarjes në hapësirë të reshjeve për territorin e Shqipërisë për muajin shtator 2023 është paraqitur në hartën e dhënë në figurën Nr.24.

Ndonëse në vlera të moderuara dhe nën normë reshjet maksimale 24 orëshe të vërtetuara gjatë muajit shtator 2023 në territorin e Shqipërisë nuk kaluan vlerat historike dhe nuk shënuan rekorde. Një shpërndarje e tyre hapësinore paraqitet në hartën e dhënë në figurën Nr.25, ku vlerat më të larta i takojnë pjesës lindore të vendit dhe asaj VP.




Nën ndikimin e një gërshetimi si të faktoreve frontale ashtu dhe karakteristikave orografike të vendit reshjet e muajit shtator 2023 shënuan anomali të theksuara. Në shkallë vendi në hartën e dhënë në figurën Nr.26 janë paraqitur vlerat e reshjeve në % kundrejt normës, ku ndonëse vlerat më të ulta i takojnë zonës JP dhe Veriore të vendit.

An overview of the spatial distribution of rainfall for the territory of Albania for the month of September 2023 is shown in the map given in figure No.24.

Although in moderate values and below the norm, the maximum 24-hour rainfall observed during the month of September 2023 in the territory of Albania did not exceed historical values and did not set records. Their spatial distribution is presented in the map given in figure No.25, where the highest values belong to the eastern part of the country and the northwestern part.

Under the influence of a combination of both frontal factors and the orographic characteristics of the country, the rainfall of September 2023 marked significant anomalies. At the country level, in the map given in figure No.26, the precipitation values are shown in % against the norm, where the lowest values belong to the SW and Northern areas of the country.



Parashikimi i reshjeve atmosferike për periudha të shkurtra kohore 1, 3, 6, 12, apo 24 orëshe është me interes në mjaft sektorë të ekonomisë së vendit. Në figurën Nr.27 paraqitet situata e parashikuar për reshjet në 24 orët në vijim, vlerësim i bërë në orën në orën 07⁰⁰ UTC të datës 6 shtator 2023, për Shqipërinë, sipas modelit Aladin dhe bazuar në produktet e platformës “SEEFFGS” ku bën pjesë dhe vendi ynë. Këto produkte rinovohen çdo orë dhe në kohë reale mund të disponohet parashikimi i reshjeve edhe për basene të vogla ujore, siç paraqitet në hartë dhe që mund të jetë me interes të caktuar për prodhues të vegjël ose të mëdhenj hidroenergjetik apo për zona të caktuara bujqësore, kur behet fjala për vlerësimin e nevojave për ujitje apo situatës së thatësirës.

The forecast of atmospheric precipitation for short time periods of 1, 3, 6, 12, or 24 hours is of interest in many sectors of the country's economy. Figure No.27 shows the predicted situation for rainfall in the next 24 hours, assessment made at 07⁰⁰ UTC on September 6, 2023, for Albania, according to the Aladin model and based on the products of the "SEEFFGS" platform, which it is a part of and our country. These products are renewed every hour and in real time the rainfall forecast can be obtained even for small water bodies, as shown on the map and which may be of particular interest for small or large hydropower producers or for certain agricultural areas; when it comes to assessing irrigation needs or drought situations.

Produkti: DHMZ Parashikimi sipas modelit ALADIN | Shkalla kohore: 24 orë | Zona: Shqipëria
Data e produktit: 05 shtator 2023 ora: 07:00 UTC | Vlefshmëria në kohë: 6 shtator 2023 ora 07:00 UTC

Product: DHMZ ALADIN FORECAST | Timescale: 24-hr | Region: "ALB"
Product Date: 2023-09-05 07:00 UTC | Valid Date: 2023-09-06 07:00 UTC





Figure Nr.27

Këto produkte me vlerë në vlerësimin e situatës së motit dhe reshjeve sidomos në rastet me dukuri ekstreme të pritshme, dhe në proceset e ri analizës, ku të dhënat në fjalë për muajin shtator 2023, të paraqitura në vijim në figurën Nr.28, mundësojnë vlerësimet e mëtejshme dhe ndihmojnë kur është fjala për të saktësuar një situatë meteorologjike kohë më pas, apo lokalizuar më mirë një zonë të prekur nga një dukuri ekstreme me reshje intensive, etj., etj.

These valuable products in the assessment of the weather and precipitation situation, especially in cases of expected extreme events, and in the reanalysis processes, where the data in question for the month of September 2023, presented below in figure No.28, enable assessments of further and help when it comes to correcting a meteorological situation later, or better locating an area affected by an extreme event with intense rainfall, etc., etc.

*Figure Nr.28 - Parashikimi 24 orësh i reshjeve për çdo ditë të muajit shtator 2023 për Shqipërinë.
Daily precipitation forecast for September 2023 for Albania.*



Sa i takon kushteve agrometeorologjike për muajin shtator 2023 duhet thënë se për shumicën e kulturave bujqësore, por dhe për bimësinë në tërësi u ofruan kushte të mira sa i takon fazave të tyre përmbyllëse fiziologjike. Gjithsesi duhet thënë se nga pamjet e dhëna në hartat në vijim, në figurën Nr.29 me vlerat e treguesit të vegetacionit NDVI, sipas javëve të

Regarding the agrometeorological conditions for September 2023, it should be said that for the majority of agricultural crops, but also for all vegetation, good conditions were offered regarding their final physiological phases. However, based to the views given in the following figure No.29 with the values of the NDVI vegetation indicator, according to the various weeks




Figure Nr.29 - Treguesi i vegetacionit NDVI për muajin shtator 2023.

Vegetation Index NDVI for September 2023.

ndryshme të këtij muaji evidentohet fakti që kryesisht në pjesën qendrore e jugore të Ultësirës Perëndimore vlerat e këtij treguesi shënojnë një ulje, e cila vjen kryesisht për shkak të temperaturave më të larta dhe thatësirës më të theksuar.

of this month the fact is evident that mainly in the central and southern part of the Western Lowlands, the values of this indicator show a decrease, which is mainly due to the higher temperatures and more severe drought.





Figura Nr.30– Vlerat e treguesit të shumës së temperaturave aktive mbi pragun 10.0°C për disa vendmatje meteorologjike të muajit shtator 2023 për Shqipërinë. The values of the sum of active air temperature above the threshold 10.0°C of some meteorological stations for September 2023 for Albania.



Gjatë këtij muaji u shënuan vlera të larta të treguesit të shumës së temperaturave aktive mbi pragun 10°C, të cilat për disa vendmatje meteorologjike paraqiten në grafikun e dhënë në figurën Nr.30.

During this month, high values of the indicator of the sum of the active temperatures above the threshold of 10°C were noted, which for some meteorological measuring points are presented in the graph given in figure No.30.

